



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
MBLEDHJA E POSAÇME E GJYQTARËVE

V E N D I M

Nr. 1, datë 24/02/2022

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË MBLEDHJES SË POSAÇME TË GJYQTARËVE
TË GJYKATËS SË LARTË PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË GJYKATËS
KUSHTETUESE

Në zbatim të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores së Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.